



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:074216

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500605

**C.nr.715/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional Ali Kosova, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), Bulevardi Bill Clinton, nr.5, Ndërtesa e Elektrokosovës, Kati II. nr.5, Prishtinë-Distrikti Prizren, kundër të paditurës E., (D.) Th., nga Prizreni, Rr. “.....” p.n. me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 435.37 euro, jashtë seancës, me datë 25.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-**

- I. REFUZHET** kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET e paditura që paditësit të i paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 435.37 euro dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e këtij kontesti, të gjitha në afat prej 15 ditësh me kërcënimin e përmbarimit” **SI E PA BAZUAR.**

**A r s y e t i m**

Paditësi Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), pranë kësaj gjykate me datë 23.06.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës E., (D.) Th., nga Prizreni, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 435.37 euro.

Në referatin e padisë ka theksuar se me aktgjykimin penal të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.129/18, të datës 17.05.2019, në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se shifrën DPZ ....., në objekt e shfrytëzon bashkëshortja e pronarit Sh.B., dhe atë E., Th., me deklarimin e saj në seancë ku është konstatuar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike në disa raste në periudha të ndryshme kohore, pasi që paditësi gjerë më tani nuk ka bërë kompensimin e demit të shkaktuar. Sipas padisë, i padituri me qëllim që t’i sjellë vetes pasuri të kundërligjshme, e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin e tensionit të ulët duke e anashkaluar njehsorin elektrik dhe duke shpenzuar energjinë elektrike pa matje dhe me veprimet e tij e paditura i ka shkaktuar

paditësit dëmin material në vlerë prej 435.37 euro. Meqenëse i padituri me kohë është njoftuar për dëmin që ia ka shkaktuar paditëses dhe të njëjtën nuk e ka kompensuar, as që ka dhënë sinjale se të njëjtën do ta përmbush në procedurë të rregullt, andaj paditësja nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpapia e paditëses.

Paditësi me parashtrësën të cilën e ka dorëzuar në gjykatë me datë 21.03.2024, ka theksuar se me datë 15.03.2024, e paditura është lajmëruar në zyrën e KEDS, ku ka paguar borxhin në tërësi për shifrën DPZ ....., ku kriteri minimal rezulton se është zbritur në -0.07 euro. Po ashtu e njëjta pranë bankës BKT në xhirrollogarinë e KEDS SH.A. ka paguar edhe shpenzimet që janë krijuar me rastin e inicimit të padisë. Si rrjedhojë e paditura ka përmbushur detyrimet ndaj KEDS SH.A. përfshirë këtu edhe shpenzimet dhe në këto rrethana heqin dorë nga padia dhe kërkesëpapia.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se *“Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës”*, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”*.

Me nenin 149 par. 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpapia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”*, poashtu në paragrafin 2 të kësaj dispozite parashihet se *‘Për heqje dorë nga kërkesëpapia nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur’*.

Andaj gjykata duke u bazuar në Nenin 3 par 1 dhe 2 si dhe në nenin 149 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2020:074216, 25.03.2024

**G j y q t a r i**

**Agron Karatash**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbdhjetë) ditësh nga dita e pranimin të njëjtë, drejtuar Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate. Bazuar në nenin 181.2 të LPK-së, ky aktgjykim mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin eventual të dhunës apo mashtrimi.